



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET
EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

REFORMA NË DREJTËSI NË ASPEKTIN INSTITUCIONAL KAPITULLI 23

Dr. Artan Spahiu
Drejtor i Përgjithshëm i AKFAL

PSE NJË REFORMË NË DREJTËSI?

Arsyet:

- Dinamika e zhvillimit të shoqërisë në aspektin ekonomik dhe shoqëror.
- Problematikat e shfaqura brenda sistemit.

Korrupsioni, keqfunksionimi, mungesa e integritetit, profesionalizmit, pavarësisë, efikasitetit, besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit ishin identifikuar dhe pranoheshin gjerësisht si fenomene dëmtoese.

Nevoja: Përmirësim të legjislacionit të institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë.

Pritshmëria e shoqërisë shqiptare:

- Rritja e integritetit të sistemit,
- Pavarësia,
- Efikasiteti,
- Besueshmëria,
- Transparenca,
- Llogaridhënia dhe përgjegjshmëria e tij.

SYNIMI I PËRGJITHSHËM I PROCESIT TË REFORMËS

Krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

Një sistem drejtësie me këto tipare është parakusht i domosdoshëm për:

- forcimin e shtetit të së drejtës,
- respektimin e lirive dhe të drejtave të individit,
- barazinë e shtetasve përpara ligjit,
- përparimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe
- ecurinë e procesit të integritimit evropian.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Reforma në sistemin e drejtësisë është e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend:

- I. Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykata Kushtetuese;
- II. Pushteti gjyqësor;
- III. Drejtësia penale;
- IV. Edukimi ligjor dhe arsimit juridik;
- V. Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira;
- VI. Masat në luftën kundër korrupsionit;
- VII. Financimi dhe mbështetja infrastrukturore e sistemit;

BAZA LIGJORE

[Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë](#), Neni 77/1 “Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme”.

[Vendim i Kuvendit Nr. 96/2014](#), datë 27.11.2014 "Për krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë".

LIGJ Nr. 76/2016

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998,
“KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 27 korrik 2016

15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare = 11 GUSHT 2016

LIGJ Nr. 76/2016

GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.

Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 125

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë.
2. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.
3. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.
4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

Neni 125

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

LIGJ Nr. 76/2016

GJYKATA E POSAÇME

Neni 135

2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. ..., para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

Neni 136

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga **Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor**, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.
2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, ... Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

Neni 136

1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga **Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit**.

LIGJ Nr. 76/2016 GJYKATA E LARTË

Neni 140

2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

- kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;
- është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të **Këshillit të Lartë Gjyqësor** kur:

- ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
- ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
- kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 140

- Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.**
- Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

(ish) KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Neni 147

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga **Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi**, si dhe **9 gjyqtarë** të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme **(15 anëtarë)**.
2. **Presidenti i Republikës është Kryetar** i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për **transferimin** e gjyqtarëve, si dhe për **përgjegjësinë e tyre disiplinore** sipas ligjit.
4. Gjyqtari mund të **shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë** për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Kundër këtij vendimi gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast, vendos me kolegje të bashkuara.

LIGJ Nr. 76/2016

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Neni 147

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë.
3. Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëvenjë përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional.
4. Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

LIGJ Nr. 76/2016

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Neni 147/a

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, ...;
- dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
- e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

Neni 147/d

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për **verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor** ndaj **gjuqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve**, anëtarëve të K.L.GJ, K.L.P dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. ILD është përgjegjës edhe për **inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë**.
3. ILD zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional.
4. ILD zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.
5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

PROKURORIA

Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.
2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si **një organ i centralizuar**.
3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 149

1. Prokurori i Përgjithshëm **emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit** për një mandat 5vjeçar, me të drejte riemerimi.
2. Prokurori i Përgjithshëm mund të **shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit**, për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.
3. Prokurorët e tjerë **emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm**.
4. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit.

Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.
2. Prokuroria është **organ i pavarur** që garanton **mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj** dhe respekton **pavarësinë e brendshme të prokurorëve** për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.
3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.
4. **Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore** për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës **janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm**. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 148/a

1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me **tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi.
2. Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar.

Neni 148/dh

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë.
2. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën **10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë** për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kritere të tjera për përzgjedhjen si dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit.
3. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme **shkarkohet** për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të **Këshillit të Lartë të Prokurorisë**.
4. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njesisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit.

LIGJ Nr. 76/2016 KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Neni 149

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton **pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën** e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga **11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët etë gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi**, nga radhët e juristëve joprokurorë.
3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve ...një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional.
4. **Dy anëtarë** joprokurorë zgjidhen nga **radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve** të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe **një anëtar nga shoqëria civile**. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

Neni 149/a

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
- dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 149/d

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë.

Neni 179

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda **tetë muajve** nga hyrja në fuqi e këtij ligji. ...

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda **tetë muajve** nga hyrja në fuqi e këtij ligji. ...

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda **dy muajve** nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit.

Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari.

9. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda **gjashtë muajve** nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

11. Presidenti i Republikës, **brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**, Nëse Presidenti i Republikës nuk i përzgjedh anëtarët brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short **brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji**. Të zgjedhurit qëndrojnë në detyrë deri në datën 31 dhjetor të vitit kur hyn në fuqi ky ligj.

NGRITJA E INSTITUCIONEVE ME VONESË

1. **Këshilli i Lartë Gjyqësor - 12.12.2018**, Zgjedhja e 6 anëtarëve gjyqtar ; Konstituimi **20.12.2018 – duhej brenda 11 Prill 2017.**
2. **Këshilli i Lartë i Prokurorisë - 11.12.2018**, Zgjedhja e 6 anëtarëve prokuror ; Konstituimi **19.12.2018 - duhej brenda 11 Prill 2017.**
3. **Inspektorit i Lartë i Drejtësisë – zgjedhur nga Kuvendi me datë 20.01.2020 - duhej brenda 11 Shkurt 2017.**
4. **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi : Shorti 07.12.2018 për KPSED 2019; Shorti 05.12.2019, për KED 2020 - duhej hedhur shorti brenda dates 16 – 21 Gusht 2016.**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është zgjedhur nga Kuvendi me date 20.01.2020.

Duke filluar nga data 01.02.2020 , është ngritur dhe funksionon Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 179/b

1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet :

- funksionimi i shtetit të së drejtës,
- pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe
- të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

3. Subjekte të vlerësimit (ex officio):

- Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë,
- Të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë,
- Ndhmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme.

4. Subjekte të vlerësimit, me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit: ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

Neni 179/b

5. Rivlerësimi kryhet nga **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)**, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të **Komisionerit Publik (KP)** shqyrtohen nga **Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese**. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje.

6. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë të pavarur dhe të paanshëm.

7. **Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës**, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.

8. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është **5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre (mbaronte në qershor 2022)**, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit është **9 vjet**. Pas shpërbërjes së komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor / Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

Ne shkurt 2022, Kuvendi miratoi me shumicë votash ndryshimet në Kushtetutë që parashikojnë zgjatjen e afateve për organet e vetingut në drejtësi me 36 muaj.

Neni A

Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta

1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37 (*fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës*), dispozitat që lidhen me barrën e provës, etj..., kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

Neni 17

Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

2. Subjektet që kalojnë me sukses rivlerësimin, sipas parashikimeve të këtij Aneksi, i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Neni B

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të **mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes** së gjithë procesit. ..udhëhiqet nga Komisioni European.
2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndërkombëtarë
3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:
 - a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për KPK, KA, KP;
 - b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe **kontribuon për kontrollin e figurës** sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit;
 - c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit;

Neni C

Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga **katër trupa gjykues** të përhershëm me **tre anëtarë secili**.
2. **Dy komisionerë publikë** përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.
3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e **llogaridhënies, integritetit dhe transparencës**, për krijimin e një sistemi gjyqësor **të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni**.
6. Presidenti i Republikës së Shqipërisë organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionin e anëtarit të K.P.K, K.P.A. dhe të Komisionerit Publik.
7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët, sipas ligjit.
15. Gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelit dhe komisionerëve publikë janë **gjuha shqipe dhe angleze**. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

Neni Ç

Rivlerësimi

1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e **pasurisë**, të **figurës** dhe të **aftësive profesionale**,
2. Komisioni dhe Kolegji i Apelit ...marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e **proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit**, si dhe duke garantuar **të drejtën për një proces të rregullt**.
3. **Institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar**, si dhe duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në të dhënat.
4. Komisioni ose Kolegji i Apelit, ...**shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij**, interviston personat e përmendur në deklaratë, ...**kanë akses të drejtpërdrejtë** në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, .., të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm.
5. **Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit** vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

Neni D

Vlerësimi i pasurive

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që **të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht**, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.
2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit.
3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. **Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.** Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.
4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.
5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit **përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi**, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni DH

Kontrolli i figurës

1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim **identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar**. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.
2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një **deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit**, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.
3. Nëse subjekti i rivlerësimit **ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit** dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.
4. Nëse subjekti i rivlerësimit **nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet**. Nëse subjekti i rivlerësimit **përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit** dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni E

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim **identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.**
2. Vlerësimi i aftësisëpërfshin aftësinë për të gjykuar, për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.
3. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit **ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta**, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo **konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit** dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.
4. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit **ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme**, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, **zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit** dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.
5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune **aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve**, zbatohet **prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit** dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni Ë

Masat disiplinore

1. Komisioni ose Kolegji i Apelimit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, **pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra.** Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar.
2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. **Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj.** Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. **Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni.**
3. Në çdo rast, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale (kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, etj.)

Neni F

Kolegji i Apelimit

- 1. Kolegji i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit. Kolegji vendos në trupa gjykuese me pesë anëtarë secili.**
- 2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit.**
- 3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, ..nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim...nuk vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit.....**
- 4. Vëzhguesi ndërkombëtar në Kolegjin e Apelimit gëzon të njëjtat të drejta si dhe vëzhguesi ndërkombëtar pranë Komisionit.**
- 5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 për qind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes.**
- 6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.**
- 7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar.**
- 8. Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.**

LIGJ Nr. 76/2016

SISTEMI I RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVË DHE PROKURORËVE

Neni G

Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.
2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

SISTEMI I RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVË DHE PROKURORËVE

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 30 qershor 2023, ka dhënë **674 vendime**, nga të cilat:

- 288 vendime konfirmim në detyrë** për 146 gjyqtarë, 129 prokurorë, 2 ish-inspektorë në KLD, 1 inspektor në KLGJ dhe 10 ndihmës/këshilltarë ligjorë;
- 231 vendime për shkarkim nga detyra** për 135 gjyqtarë, 1 ish-gjyqtare në GJL, 92 prokurorë, 1 inspektor në KLGJ dhe 2 ndihmës ligjorë;
- 96 vendime për ndërprerje procesi (Dorëheqje)** për 58 gjyqtarë, 24 prokurorë, 1 ish-prokuror, 12 ndihmës ligjorë, 1 ish-inspektorë në KLD;
- 8 vendime për pushimin e procesit** për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë (neni 56 i ligjit nr. 84/2016);
- 47 vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar** për 25 gjyqtarë, 16 prokurorë, 1 ish-kryeinspektor në KLD dhe 2 ish-inspektor në KLD dhe 3 ndihmës ligjor (neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 64 i ligjit nr. 96/2016);
- 4 vendime për pezullimin nga detyra** për 3 prokurorë dhe 1 ndihmës ligjor;

Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit 2018 – 2023 : 149 vendime të lëna në fuqi dhe 47 vendime të ndryshuara apo të prishura.

KUADRI LIGJOR I MIRATUAR, I REFORMËS

- Ligj nr. 84/2016 datë 6.10.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK – BKH)”;
- Ligj nr. 96/2016 datë 6.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017;**
- Ligj nr. 97/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 98/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për disa ndryshime të Ligjit nr. 8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligj nr. 115/2016 datë 3.11.2016 Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë:, **shfuqizuar nene me vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 10.4.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017;**

INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Ligj nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK – BKH)”;

Neni 4

Prokuroria e Posaçme (SPAK)

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para **Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë**, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.
2. Prokuroria e Posaçme i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, nëpërmjet prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me këtë ligj.

Neni 5

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 8

Kompetenca lëndore parësore

1. Kompetenca lëndore parësore e **gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar** parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës.

Kodi i Procedurës Penale;

Neni 75/a

Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

- a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;
- b) çdo vepër penale e kryer nga **grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur**, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;
- c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anetarit të Keshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkise, deputetit, zëvendësministrit, anetarit të Keshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Keshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
- ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.



INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

- Ligj nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK – BKH)”;

Neni 13

Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme

1. Prokurorët e posaçëm, në ushtrimin e funksioneve të tyre, veprojnë dhe marrin vendime në **mënyrë të pavarur**, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.
2. Prokurorët e posaçëm zbatojnë udhëzimet e përgjithshme, të dhëna me shkrim nga prokurori më i lartë, sipas këtij ligji. **Prokurori më i lartë nuk mund t’i japë udhëzime një prokurori të posaçëm lidhur me thelbin e hetimit apo çështjes.**
3. **Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve** gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm, nga çdo autoritet publik a privat.



KOMISIONI I PAVARUR

për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 288.
- Vendimi i Kuvendit nr.74, datë 31.5.2018 “Për ngritjen e komisionit të pavaruar për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit Nr.115/2016”.
- Zgjedhja e 5 anëtarëve të këtij komisioni është bërë nga Kuvendi, nëpërmjet Vendimit Nr.97 datë 20.9.2018 (4 anëtarë) dhe Vendimit nr.109 datë 25.10.2018 (1 anëtar).
- Më datë **5 nëntor 2018** është bërë konstituimi i Komisionit të Pavarur, si dhe zgjedhja e Kryetarit dhe Sekretarit të këtij Komisioni.
- Më datë 9 nëntor 2018 është miratuar Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Pavarur

KOMISIONI I PAVARUR

për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

- Neni 288 i ligjit nr.115/2016
- Vendimi i Kuvendit nr.74/2018, pika II.

Dy drejtimet kryesore të veprimtarisë së Komisionit:

- 1. Monitorimi i proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes së anëtarëve të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë, të zhvilluara pas konstituimit të Komisionit të Pavarur të Monitorimit.**
- 2. Koordinimi midis institucioneve dhe organeve që Kushtetuta dhe ligji nr.115/2016 ngarkon me detyra konkrete për ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.**

Përfundimi i veprimtarisë së Komisionit të Pavarur të Monitorimit

Komisioni i Pavarur i ushtron funksionet e tij deri në përfundimin e procesit të krijimit dhe fillimin e veprimtarisë së organeve, sipas parashikimeve në ligjin nr. 115/2016.

Neni 1 i Ligjit nr.115/2016, Organe të Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë janë:

1. **Këshilli i Lartë Gjyqësor - 12.12.2018**, Zgjedhja e 6 anëtarëve gjyqtar ; Konstituimi **20.12.2018**.
2. **Këshilli i Lartë i Prokurorisë - 11.12.2018**, Zgjedhja e 6 anëtarëve prokuror ; Konstituimi **19.12.2018**.
3. **Inspektorit i Lartë i Drejtësisë – zgjedhur nga Kuvendi me datë 20.01.2020.**
4. **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi : Shorti 07.12.2018** për KPSED 2019; Shorti **05.12.2019**, për KED 2020.
5. **Shkolla e Magjistraturës**, - funksionale edhe para miratimit të ndryshimeve ligjore.

Organi i fundit i qeverisjes së sistemit të drejtësisë , i ngritur për herë të parë, është **Inspektor të Lartë të Drejtësisë** , i cili është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin Nr.2, date **20.01.2020**.

Duke filluar nga data **01.02.2020** , në mbështetje të nenit 283, pika 8 të Ligjit nr.115/2016, është ngritur dhe funksionon **Zyra e Inspektori të Lartë të Drejtësisë**.

Komisioni i Pavarur, me vendimin nr.29, datë **28.02.2020.**, ka miratuar Raportin Përmbledhës “Mbi Veprimtarinë e Komisionit të Pavarur për Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (për periudhën 5 Nëntor 2018 –28 Shkurt 2020)”.

KOMISIONI I PAVARUR

për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

Raportimet e Komisionit të Pavarur

- Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë të cilave i drejtoheshin me rekomandime përkatëse këto raporte.
- Janë bërë publike në rubrikën e dedikuar për Komisionin e Pavarur, në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.



Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi
 - **Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë**
- Ligje, VKM, Dokumenta Zyrtare
 - **Ligji Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 27 korrik 2016**
 - **VKM Nr. 247, datë 20.3.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, për periudhën 2015-2020”.**
- Linke të dobishme
 - <https://rm.coe.int/strategjia-ne-refomen-e-sistemit-te-drejtësisë/16809eb53a>





Faleminderit për vëmendjen!

Dr. Artan Spahiu

artan.spahiu@arsimi.gov.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES